

KRYETARI I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (LDK), LUMIR ABDIXHIKU,
KA MBAJTUR TË MARTËN KONFERENCË PËR MEDIE

ABDIXHIKU PROPOZON QEVERI
NACIONALE TË TRANZICIONIT



Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka njoftuar të martën se i ka ftuar të gjitha partitë parlamentare shqiptare të takohen së bashku për ta formuar një qeveri tranzitore. Propozimi i Abdixhikut vjen pas

një letre që ai e ka marrë nga partia fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit, Lëvizja Vetëvendosje, për koalicion qeverisës dhe pas dështimeve të njëpasnjëshme për formimin e institucioneve të reja rreth tre muaj pas zgjedhjeve. “Kjo qeveri

nacionale e tranzicionit do të ketë afat të caktuar, qëllime të qarta politike dhe ekzekutive, program dhe agjendë ekzekutive të dakorduar, si dhe kryeministër dhe kabinet përfaqësues dhe unifikues”, ka thënë Abdixhiku

KRASNIQI TAKON
AHMETIN, FLASIN
PËR POZICIONIN
E SHQIPTARËVE
NË MAQEDONINË
E VERIUT

F. 6



TENTATIVA E
DYMBËDHJETË
PËR
KONSTITUIMIN
E KUVENDIT

F. 6



AKTUALE



CILA DO TË ISHTE KOSTOJA E
VIZITËS SË VUÇIQIT NË MOSKË PËR
SERBINË DHE QYTETARËT E SAJ?

F. 3

VDIQ KAQUSHA JASHARI,
ISH-AKTIVISTE POLITIKE DHE
THEMELUESE E PSDK-së

F. 7

ATK-ja BËN THIRRJE TË PAGUHEN
TATIMET PËR TË ARDHURAT
E REALIZUARA NGA FURNIZIMET
ELEKTRONIKE

F. 6

EKONOMI



SHALA: QEVERIA KURTI PO U
GARANTON MILIONA KEDS-it,
KESCO-s, NOA-s DHE GEN-it
NË KURRIZ TË QYTETARËVE

F. 7

OEK-u KËRKON PEZULLIM
TË VENDIMIT PËR SHITURITIM
TË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR BIZNESET

F. 7

SPORT



PSG-ja DHE ARSENALE NË KËRKIM
TË FINALES

F. 10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji
BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Merz zgjidhet kancelar i Gjermanisë

BERLIN, 6 MAJ - Udhëheqësi konservator Friedrich Merz është zgjedhur kancelar i ri i Gjermanisë nga Parlamenti të martën në raundin e dytë të votimit, disa orë pasi dështoi të emërohej në votimin e parë. Me 325 vota për, 289 kundër, një abstenim dhe tri vota të pavlefshme, Merz do të jetë kancelar i ri i Gjermanisë. “Ju falënderoj për besimin dhe e pranoj zgjedhjen”, deklaroi Friedrich Merz, pasi u pyet nga presidentja e Bundestagut, Julia Klöckner, a e pranon zgjedhjen. Edhe pse konservatorët fituan zgjedhjet me 28.5 për qind të votave, ata kishin nevojë për një partner për të formuar qeveri shumice.

Të hënën ata nënshkruan një marrëveshje koalicioni me SPD-në, e cila kishte dalë me rezultatin më të dobët në historinë e saj pas Luftës së Dytë Botërore, vetëm 16.4 për qind. Aleanca CDU/CSU e udhëhequr nga Merzi dhe partneri në koalicion, Partia Socialdemokrate (SPD), janë zotuar se do ta ringjallin ekonominë e dobësuar dhe se do ta rindërtojnë ushtrinë në një kohë kur presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, e ka vënë në dyshim të ardhmen e sigurisë dhe lidhjeve tregtare transatlantike. Merz, gjithashtu, është zotuar se do ta frenojë emigracionin



e parregullt dhe se do ta ndalë rritjen e partisë kundër emigracionit, Alternativa për Gjermaninë (AfD), e cila doli

në vend të dytë në zgjedhjet e parakohshme të shkurtit. AfD-ja u shpall të premtën “grup ekstremist i krahut të

djathtë” nga shërbimi i inteligjencës së brendshme të Gjermanisë - një veprim që ka nxitur një përplasje të re me administratën Trump, dhe kundër të cilit AfD-ja nisi veprime ligjore të hënën. Merz, i cili ka përvojë të madhe në biznes, por zero përvojë në poste drejtuese qeveritare, në ceremoninë e nënshkrimit të së hënës premtoi “qeverisje të fortë, të besueshme dhe të planifikuar mirë”. “Ne jetojmë në kohë ndryshimesh të thella, përmbysjesh të thella... dhe pasigurie të madhe, dhe kjo është arsyeja pse ne e dimë se është detyra jonë historike ta udhëheqim këtë koalicion drejt suksesit”, tha ai.

Britania drejt kufizimeve për studentët nga vendet më të prira për të kërkuar azil

LONDËR, 6 MAJ - Qeveria britanike mund t'i kufizojë aplikimet për viza nga studentë që jetojnë në vende që konsiderohen më të prira të kërkojnë azil, në një përpjekje për ta ulur migracionin, tha një zyrtar qeveritar. Ky hap vjen pasi Partia Laburiste e kryeministrit Keir Starmer u ndëshkua në zgjedhjet lokale në Angli javën e kaluar nga votues të zemëruar për çështje si migracioni i paligjshëm. Qeveria pritet ta publikojë javën e ardhshme një dokument politik, i njohur si “libri i bardhë”, që do ta paraqesë planin se si synon ta ulë



migracionin neto, i cili arriti 728 000 persona në vitin deri në qershor të vitit të kaluar. “Libri i bardhë për migracionin që po përgatisim do të paraqesë një plan gjithëpërfshirës për të rivendosur rregull në sistemin tonë të thyer të imigracionit”, thuhet në një deklaratë të Ministrisë së Brendshme, raporton “Reuters”. Nivelet e larta të migracionit legal kanë dominuar prej kohësh në debatin politik në Britani dhe ishin një nga shtysat kryesore për referendumin e Brexit-it në vitin 2016. Nga 108 000 persona që kërkuar azil në Britani vitin e kaluar, 16

000 kishin viza studentore, tregojnë të dhënat qeveritare. Qeveria nuk jep një ndarje sipas kombësive të atyre që kishin viza studentore dhe që më pas kërkuar azil. Por qeveria tha se personat nga Pakistani, Nigeria dhe Shri Lanka janë më të prirë të kërkojnë azil në Britani pasi mbërrijnë me vizë pune, studentore apo vizitori. Pas rezultateve të dobëta të Partisë Laburiste në zgjedhjet lokale javën e kaluar, disa deputetë laburistë i bënë thirrje qeverisë të marrë një qasje më vendimtare për çështje si ulja e migracionit.

Ushtria izraelite i paralajmëron njerëzit të largohen nga zonat afër aeroportit Sana

Sana, 6 maj - Ushtria e Izraelitë i ka paralajmëruar njerëzit të martën të largohen nga pjesët përreth aeroportit kryesor të kryeqytetit të Jemenit, Sana. Ky paralajmërim vjen një ditë pasi ushtria izraelite e goditi portin e Hudejdës si përgjigje ndaj sulmit raketor që rebelët Huthi e kryen në afërsi të aeroportit kryesor të Izraelit. Tensionet janë përshkallëzuar mes Izraelit dhe rebelëve Huthi të Jemenit, sepse grupi i lidhur me Iranin po vazhdon të kryejë

sulme si përgjigje ndaj zgjerimit të operacioneve të Izraelit në Rripin e Gazës. “Mosevakuimi ju vë në rrezik”, tha ushtria izraelite drejtuar njerëzve në Sana. Ajo e publikoi një hartë të zonës përreth Aeroportit Ndërkombëtar të Sanas. Izraeli e sulmoi portin e Hudejdës në Jemen të hënën, duke i vrarë katër njerëz dhe duke i plagosur 39 të tjerë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë të kontrolluar nga Huthi. Kryeministri i Izraelit, Benjamin

Netanyahu, u zotua për hakmarrje pasi një raketë e lëshuar nga rebelët Huthi ra pranë Aeroportit Ben Gurion të Izraelit. Sulmoi i detyroi kompanitë ajrore evropiane dhe amerikane t'i pezullojnë fluturimet drejt Tel Avivit për disa ditë. Rebelët Huthi kanë kryer sulme ndaj Izraelit dhe anijeve në Detin e Kuq që nga fillimi i luftës mes Izraelit dhe Hamasit në Gazë, siç thonë ata, në shenjë solidariteti me palestinezët.



Hamasi është i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet

e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Irani thotë se ka testuar një raketë që mund të arrijë në Izrael e papenguar

Teheran, 6 maj - Irani ka thënë se e ka testuar “suksesshëm” një raketë të re balistike, duke pretenduar se ajo mund të arrijë në Izrael dhe se ajo mund t'i përshkojë tejprtej disa prej

mbrojtjeve më të avancuara raketore në botë. Në një kohë kur shqetësimet në Perëndim janë duke u rritur për përparimin e programeve bërthamore dhe raketore të

Teheranit, televizioni shtetëror iranian transmetoi më 4 maj pamje të testimit të raketës “Qassem Basir”, e cila duket se godet cakun e saj. Ministri i Mbrojtjes i Iranit, Aziz

Nasirzadeh, tha se raketa me lëndë djegëse të ngurtë ka një rreze veprimi prej 1.200 kilometrash dhe është në gjendje ta përshkojë tejprtej sistemin e avancuar të mbrojtjes raketore



THAAD, të cilin Shtetet e Bashkuara e vendosën në Izrael vitin e kaluar.

CILA DO TË ISHTE KOSTOJA E VIZITËS SË VUÇIQIT NË MOSKË PËR SERBINË DHE QYTETARËT E SAJ?

PRISHTINË, 6 MAJ - Vizita e paralajmëruar shumë herë e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Moskë, po shihet me shqetësim për shkak të pasojave të mundshme për rrugën evropiane të Serbisë. Vendimin për të marrë pjesë në paradën e Ditës së Fitores kundër fashizmit më 9 maj, Vuçiqi e bëri në fillim të marsit, pas një bisede telefonike me presidentin rus Vladimir Putin. Nëse Vuçiqi do të udhëtonte në Moskë, ku do të takohej për herë të parë fizikisht me Putinin që nga fillimi i pushtimit rus të Ukrainës, kjo do të kishte pasoja serioze për procesin e integritetit evropian të Serbisë, vlerëson për Radion Evropa e Lirë diplomati në pension, Sreqko Gjukiq. “Kjo mund të jetë e dobishme për regjimin serb, por nuk është aspak e dobishme për rrugën evropiane të Serbisë, as për Bashkimin Evropian si një entitet i fuqishëm ekonomik e politik në arenën ndërkombëtare dhe, sigurisht, as për vendet e tjera kandidatë për anëtarësim në BE”, shpjegon Gjukiq.

Çfarë thotë Brukseli?

Serbia është në negociata për anëtarësim në BE që nga viti 2014. Ajo nuk është rreshtuar me sanksionet e BE-së ndaj Rusisë për shkak të agresionit ndaj Ukrainës, dhe autoritetet në Beograd kanë vazhduar marrëdhëniet me Moskën edhe pas vitit 2022, përkundër paralajmërimeve nga Brukseli. Paralajmërimi më i fundit erdhi nga komisionarja evropiane për zgjerim, Marta Kos, e cila vizitoi Beogradin në fund të prillit. Në një konferencë për medie më 29 prill, ajo tha se “është vendim i presidentit të Serbisë nëse do të shkojë në Moskë”, por paralajmëroi se nëse Vuçiqi shkon, ajo do ta ketë “shumë më të vështirë ta ndihmojë Serbinë të mbetet fuqishëm në rrugën evropiane”. “Të shkosh në Moskë dhe të festosh me Putinin apo me ushtrinë e tij që vret njerëz në Ukrainë është thellësisht në kundërshtim me vlerat evropiane dhe vendimin e Këshillit të BE-së të vitit 2022 që shtetet anëtare të mos ndërmarrin asnjë veprim që do t'i legjitimonte Putinin dhe Rusinë”, tha Kos. Departamenti amerikan i Shtetit nuk ka dhënë ende



përgjigje për pyetjet e REL-it lidhur me paralajmërimin e Vuçiqit për vizitën në Moskë.

Çfarë është në rrezik?

Pas vitesh balancimi në mes të Perëndimit dhe Lindjes, rruga evropiane e Serbisë është komprometuar, vlerëson ish-diplomati Gjukiq. Ai thotë se në rast të shkuarjes së Vuçiqit në Moskë, “duhet pritur veprime të caktuara” nga Brukseli. “Është e mundur që nga arsenalin e pasur që BE ka ndaj Serbisë - përfshirë ndihmat financiare, donacionet, mbështetjen politike dhe regjimin pa viza - të gjitha ose një pjesë të rishikohen dhe të vihen në pikëpyetje”, thotë Gjukiqi. Bashkimi Evropian është partneri më i rëndësishëm tregtar i Serbisë. Nga vendet e BE-së vjen edhe pjesa më e madhe e investimeve të huaja direkte. Gjukiqi shton se afërsia e Serbisë me Rusinë nuk rrezikon vetëm rrugën e saj drejt BE-së, por ndikon negativisht edhe te shtetet e tjera kandidatë për anëtarësim. “Nuk është më e mundur të luhatet mes Lindjes dhe Perëndimit. Kjo duhet të marrë fund”, përfundon ai.

Kujt po i dërgon mesazh Vuçiqi?

Për Jelica Kurjak, ish-ambasadore e Serbisë në Moskë, paralajmërimi i Vuçiqit për vizitën në Moskë është më shumë një mesazh për BE-në sesa për Putinin. “Ai ndoshta mendon se me këtë do t'i tregojë BE-së se nuk varet vetëm nga ata, se ka Rusinë pas vetes, dhe kështu përpiqet ta forcojë imazhin e tij, për t'i bërë presion”, vlerëson Kurjak. Sipas saj, nuk ekziston asnjë arsye tjetër e justifikueshme. Ajo përmend edhe kritikën që u janë bërë autoriteteve në Beograd nga BE-ja për shkak të protestave të zgjatura të studentëve, që kërkojnë përgjegjësi për vdekjen e 16 personave nga shembja e një strehe betoni në stacionin e trenit në Novi Sad. Sa iu përket negociatave për kompaninë NIS dhe furnizimet me gaz natyror rus, Kurjak thotë se nuk është i nevojshëm një takim ballë për ballë mes Vuçiqit dhe Putinit. “Në këtë rast konkret me NIS-in, nuk varet asgjë nga Rusia. Amerika ka vendosur sanksione ndaj kompanisë që bleu

kompaninë tonë. Pra, Amerika do të vendosë kur dhe çfarë do të ndodhë”, thekson Kurjak. ShBA-ja e shtyu për herë të tretë zbatimin e sanksioneve ndaj NIS-it në fund të prillit, edhe pse kompania është në listën e zezë që nga 10 janari për shkak të lidhjeve me Gazprom Neftin rus, që ndodhet nën sanksionet perëndimore për shkak të agresionit në Ukrainë. Kur flitet për një marrëveshje të re për gazin, marrë parasysh që ajo aktuale skadon në fund të majit, Kurjak kujton se marrëveshja e fundit ishte arritur në maj 2022 - tre muaj pas nisjes së pushtimit të Ukrainës nga Rusia - pa pasur nevojë që Vuçiqi të shkonte në Moskë.

Kush e ka konfirmuar pjesëmarrjen në Moskë?

Nga liderët evropianë, pjesëmarrjen në Moskë e kanë konfirmuar vetëm Vuçiqi dhe kryeministri sllovak Robert Fico, një aleat i afërt i Kremlinit. Vizitën e ka paralajmëruar edhe Milorad Dodik, presidenti i entitetit serb në Bosnjë-Hercegovinë, Republika Srpska.

Dodiku është takuar disa herë me Putinin që nga fillimi i agresionit rus, për herë të fundit më 1 prill. Presidenti i Kinës, Xi Jinping, do të qëndrojë në Rusi nga 7 deri më 9 maj, në kuadër të një vizite zyrtare që përfshin takime bilaterale dhe nënshkrim marrëveshjesh. Sipas agjencisë shtetërore ruse “RIA Novosti”, pjesëmarrjen në paradë më 9 maj e kanë konfirmuar edhe presidenti i Bjellorusisë, i Kazakistanit, i Azerbajxhanit, i Venezuelës, i Brazilit dhe përfaqësues nga Kongo e Burkina Faso.

Ku ndodhet Serbia në rrugën drejt BE-së?

Që nga dhjetori i vitit 2021 Serbia nuk ka hapur asnjë kapitull negociues apo klaster të ri me BE-në. Për hapjen e një klasteri nevojitet konsensus i plotë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Që nga viti 2014, kur nisi zyrtarisht negociatat, Brukseli e ka përmendur vazhdimisht çështjen e marrëdhënieve me Kosovën si pengesën kryesore. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE ka ngecur. Në raportin e fundit të Komisionit Evropian për Serbinë janë listuar probleme serioze si, gjendja e sundimit të ligjit, korrupsioni i përhapur, kontrolli shtetëror mbi mediet, ndikimi i qeverisë në gjyqësor, mungesa e dënimeve për krimet e luftës të viteve '90 dhe lartësimi i kriminelëve të luftës. Po ashtu, është theksuar mospërputhja me politikën e jashtme të BE-së. Gjatë vizitës së saj në Beograd, komisionarja Kos ka theksuar nevojën për reforma në drejtësi, luftën kundër korrupsionit, lirinë e medieve dhe përmirësimin e procesit zgjedhor. “Punoni me ne për reformat në mënyrë që anëtarësimi juaj në Bashkimin Evropian të jetë i mundur”, u shpreh Kos pas takimit me kryeministrin e Serbisë, Gjuro Macuta, më 29 prill. Serbia është pjesë e Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor, i cili parasheh një fond prej gjashtë miliardë eurosh. Megjithatë, për shkak të mungesës së përparimit në dialogun me Kosovën, as Serbia e as Kosova nuk kanë përfutur ende nga faza e parë e këtij plani që parasheh para në formë paradhënieje. /Rel



KRYETARI I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (LDK), LUMIR ABDIXHIKU,
KA MBAJTUR TË MARTËN KONFERENCË PËR MEDIE

ABDIXHIKU PROPOZON QEVERI NACIONALE TË TRANZICIONIT

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka njoftuar të martën se i ka ftuar të gjitha partitë parlamentare shqiptare të takohen së bashku për ta formuar një qeveri tranzitore. Propozimi i Abdixhikut vjen pas një letre që ai e ka marrë nga partia fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit, Lëvizja Vetëvendosje, për koalicion qeverisës dhe pas dështimeve të njëpasnjëshme për formimin e institucioneve të reja rreth tre muaj pas zgjedhjeve. “Kjo qeveri nacionale e tranzicionit do të ketë afat të caktuar, qëllime të qarta politike dhe ekzekutive, program dhe agjendë ekzekutive të dakorduar, si dhe kryeministër dhe kabinet përfaqësues dhe unifikues”, ka thënë Abdixhiku.

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 MAJ - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, i ka kthyer përgjigje kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurtit, në lidhje me letrën që i kishte dërguar për koalicion bashkëqeverisës. Abdixhiku e ka njoftuar Kurtin se qëndrimet dhe bindjet e LDK-së mbesin konsistente. Ai ka propozuar fillimin e një

procesi të ri konsultativ, që parasheh përfshirjen e partive politike parlamentare shqiptare, me qëllim formimin e një qeverie nacionale të tranzicionit. “Të dashur qytetarë, pas letrës së djeshme, sot i kam kthyer përgjigje kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje!, z. Albin Kurtit, po ashtu përmes një letre. Z. Kurti e kam njoftuar se qëndrimet dhe bindjet e LDK-së mbesin konsistente. Kam propozuar dhe fillimin e një procesi të ri konsultativ, që

parasheh përfshirjen e partive politike parlamentare shqiptare, me qëllim formimin e një qeverie nacionale të tranzicionit. Kjo qeveri nacionale e tranzicionit do të ketë afat të caktuar, qëllime të qarta politike dhe ekzekutive, program dhe agjendë ekzekutive të dakorduar, si dhe kryeministër dhe kabinet përfaqësues dhe unifikues. LDK-ja shpreh gatishmërinë të drejtojë këtë proces konsultativ për të zgjidhur krizën aktuale dhe

garantimin e stabilitetit kombëtar në vend. Shpresoj në reflektim të përgjegjshëm nga të gjithë. Për këtë proces, kam njoftuar dhe partitë tjera shqiptare në Parlamentin e Kosovës. Përkatësisht z. Krasniqi, z. Haradinaj dhe z. Limaj”, ka thënë Abdixhiku të martën në një konferencë për medie. Ai tha se qeveria e tranzicionit do të kishte një kryeministër “unifikues” dhe se do të zgjaste deri në kohën kur vendi duhet ta zgjedhë presidentin e ri, pra në prill të vitit 2026, kur presidentes së tanishme Vjosa Osmani i mbaron mandati. “Po flasim për qeveri nacionale të tranzicionit, të unitetit të tanishëm, të domosdoshëm për Kosovën dhe me afat të shkurtër. Me kryeministër dhe kabinet unifikues deri në zgjedhjen e presidentit të Kosovës”, u përgjigje Abdixhiku pas interesimit të gazetarëve se kush duhet të jetë kryeministër. Kurti e përsëriti të martën gjatë

një ngjarjeje në Gjiçan se ai do të jetë kryeministër. “Unë do të jem kryeministër dhe vazhdojmë tutje”, i pyetur rreth formimit të institucioneve të reja. Abdixhiku tha se disa prej liderëve të partive parlamentare kanë shprehur gatishmëri për këtë dhe se Ramush Haradinaj i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e ka pranuar ftesën. Vetëvendosja i fitoi zgjedhjet e 9 shkurtit, me rreth 42 për qind të votave, apo 48 ulëse, që është pamjaftueshëm për të qeverisur e vetme. Pas LV-së më së shumti vota fitoi Partia Demokratike e Kosovës, 24 ulëse, kurse LDK-ja 20 sosh. AAK-ja dhe Nisma i fituan tetë ulëse, prej të cilave tri i takojnë kësaj të fundit. Gati tre muaj pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, procesi ka ngecur për shkak të mospajtimeve mes disa prej partive më të mëdha parlamentare për pozitën e kryetarit të Kuvendit.

TENTATIVA E DYMBËDHJETË PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT

Seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës do të vazhdojë sot (e mërkurë) në orën 10:00, pasi as në tentativën e njëmbëdhjetë nuk ka arritur të konstituohet ky institucion. Albulena Haxhiu po konsiderohet figurë përçarëse nga partitë parlamentare, PDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte kanë kërkuar që LV-ja të nxjerrë emër tjetër për kryeparlamentar, ndërkaq LDK-ja ka thënë se nuk do të votojnë asnjë kandidat të propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 MAJ - Sot (e mërkurë) për të dymbëdhjetën herë me radhë deputetët e Kuvendit të Kosovës do të mblihdhen për ta konstituuar përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e shkurtit. Ligjbërësit refuzuan për të tretën herë rresht që ta formojnë një komision për votimin e fshehtë për kreun e ri të organit ligjvënës.

Në vazhdimin e seancës konstituive mbajtur të hënën, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK-ja), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe refuzuan të propozojnë një përfaqësues që do ta siguronte mbarëvajtjen e votimit të fshehtë.

Deputetë të partive që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë thonë se është jokushtetuese mënyra se si LV-ja po tenton që kryeparlamentari të votohet përmes formës së fshehtë.

Kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj, atë ditë kishte paralajmëruar se deputetët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve. Por, procesi ka ngecur te pika e tretë: te zgjedhja e kryeparlamentarit.

Propozimi për kryeparlamentar është e drejtë ekskluzive e fitueses së zgjedhjeve, LV-së, por në gjashtë votime, kandidatja e saj, Albulena Haxhiu, nuk ka arritur t'i marrë votat e nevojshme, përkatësisht 61.

Partitë që po kundërshtojnë emrin e Haxhiut për kryeparlamentare i kanë kërkuar LV-së ta ndryshojë propozimin për të në mënyrë që procesi të zhblllokohet.

Deputeti i PDK-së, njëherësh kryetar i kësaj partie, Memli Krasniqi, tha, pas dështimit të radhës për konstituimin e Kuvendit, se LV-ja, “në mungesë të shumicës parlamentare, është duke dhunuar jo vetëm këtë institucion, por edhe shtetin”. Krasniqi ka thënë se po duket që për kreun e LV-së, Kurtin, “Haxhiu është më e

rëndësishme se qytetarët që kanë votuar në zgjedhje dhe kanë dhënë verdiktin e tyre”. “Në mungesë të besimit, në mungesë të numrave, në mungesë të shumicës për t'u bërë vetë kryeministër, ai po luan me Albulena Haxhiun...”, është shprehur Krasniqi.

Kurti, sipas tij, “e ka më të lehtë ta sakrifikojë atë sesa që të matet vetë. Secili e di që ai nuk i ka numrat”.

Krasniqi ka thënë se LV-ja “nuk mund ta mbajë peng me zor shtetin”. “Nëse vërtet dëshiron të kemi rrugëdalje, e ftoj ta ndryshojë kandidaten”, ka thënë ai.

Deputeti i LV-së, Hekuran Murati, ka thënë se “vullneti i deputetit po vazhdon të ndrydhet përmes insistimit për votim të hapur”. “Votimi i fshehtë është mënyrë kushtetuese si të dilet nga situata”, është shprehur ai. Sipas Muratit, partitë opozitare vazhdojnë të mos u besojnë deputetëve të tyre.

Ai ka theksuar se votimi i fshehtë nuk përbën kurrfarë shkelje.

Murati ka thënë se LV-ja është e interesuar që me partitë e tjera të gjejë pajtim për rrugën përpara, teksa ka konfirmuar se ajo është e hapur për “diskutim për marrëveshje politike”.

Deputeti i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se bllokimi i Kuvendit është pasojë e mosbashkëpunimit në mes të LV-së dhe partive që dikur ishin në opozitë. Ai ka thënë se “nuk ka mirëbesim mes partive politike” dhe se kjo “është për keqardhje”. Sipas tij, mirëbesimi mund të arrihet “vetëm me veprime konkrete nga Kurti”. Ai ka kërkuar që Kurti të kërkojë falje “për gjuhën ofenduese dhe sjelljen degraduese” dhe të marrë përgjegjësi për gjendjen e vendit sot.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka deklaruar se është përgjegjësi e tri partive politike më të mëdha në vend për ta tejkaluar këtë krizë. Sipas tij, Nisma do të japë kontributin e saj që vendi të mos ketë krizë institucionale.

Limaj, pas dështimit të 11-të të konstituimit të Kuvendit të Kosovës, i ftoi partitë e mëdha të marrin kohë dhe të gjejnë zgjidhje. “Besoj se tashmë janë bërë të gjitha ushtrimet, taktizimet, që janë normale. Ndonjëherë në politikë është



një gjendje e qartë se cili është raporti i forcave në parlament. Ftesa ime është për tri partitë e mëdha që ta marrin kohën e duhur sa iu duhet, të gjejnë rrugë edhe ligjore dhe të gjejnë një zgjidhje e cila do të çonte në krijimin e institucioneve të Kosovës, të parlamentit dhe qeverisë. Tashmë besoj se për secilin është e qartë tema këtu është qeveria e jo vetëm kryetari i Kuvendit”, thotë Limaj.

Sipas tij, këto vonesa janë të panevojshme dhe sa më shpejt duhet të gjendet një marrëveshje politike. “Kjo kështu është një reprizë e panevojshme, një vonesë e panevojshme. Duhet të gjenden rrugë, dhe rrugët gjenden përmes marrëveshjeve politike, përmes kompromiseve. Kosova duhet ta shohë një shumicë parlamentare, e nëse partia e parë nuk e ka shumicën, atëherë le ta bëjnë të tjerët shumicën, ama një shumicë duhet të bëhet dhe përgjegjësinë po e them e kanë tri partitë e mëdha për ta nxjerrë vendin nga kriza. Nisma do të jetë këtu për ta dhënë kontributin e vet që Kosova mos të ketë krizë institucionale dhe kjo është ajo që mund të bëjmë tani për tani”, thotë ai.

Kreu i Nismës, Limaj, tha se derisa 61 vota janë problem të sigurohen, s'mund të mendohet për çështjen e presidentit.

Haxhiu po konsiderohet figurë përçarëse nga dy parti parlamentare, PDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte kanë kërkuar që LV-ja të nxjerrë

emër tjetër për kryeparlamentar, madje AAK-ja ka përmendur edhe dy emra - Saranda Bogujevcin dhe Shqipe Selimin - nga partia e kryeministrit në detyrë, Kurti, të cilat ka thënë se do t'i votonte.

LDK-ja, ndërkaq, ka thënë se nuk ka vota për asnjë të propozuar të LV-së për pozitën e kryeparlamentarit. Por, LV-ja ka argumentuar se Haxhiu është kandidate meritorë dhe ka refuzuar thirrjet për të vendosur dikë tjetër në emër të saj.

Partitë, që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë, e kanë akuzuar LV-në se po synon ta imponojë votimin e Haxhiut dhe me “qëllim po bllokun procesin”, pasi kanë argumentuar se kjo parti nuk i ka as votat për Qeverinë e re të Kosovës - proces që pason konstituimin e Kuvendit - për formimin e së cilës, po ashtu, kërkohet shumica e thjeshtë prej 61 votash. Por LV-ja ka thënë se nuk po i detyron partitë ta mbështesin kandidaten e saj për kryeparlamentare. Kjo parti ka thënë se nuk është e interesuar për mbajtjen e zgjedhjeve të reja, por është e gatshme për një cikël të ri zgjedhor, si opsion i fundit për dalje nga situata e krijuar.

LV-ja më herët ka propozuar që së bashku me PDK-në dhe LDK-në të pajtohen që të votohen në paketë Haxhiu dhe tre nënkryetarët e Kuvendit - teksa dy nënkryetarë të tjerë u takojnë komuniteteve pakicë. Në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, LV-ja i ka fituar 48 ulëse në Kuvend, PDK-ja 24,

LDK-ja 20, AAK-Nisma tetë, tri prej të cilave i takojnë kësaj të fundit dhe kjo ndarje e ulëseve në Kuvend ia pamundëson secilës parti që të qeverisë e vetme.

Formimin e institucioneve të reja po e kërkon bashkësia ndërkombëtare - Bashkimi Evropian - që ka thënë se Kosova duhet t'i formojë shpejt institucionet e reja.

Ndërkaq, më 30 prill, ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, ka shprehur shqetësimin e tij për vonesat në krijimin e institucioneve. Ai u ka bërë thirrje partive politike të veprojnë shpejt në këtë drejtim dhe t'i shohin interesat shtetërore para atyre partiake. Seanca konstituive, që ka nisur më 15 prill, mund të ndërpritet dhe të vazhdohet sërish brenda 48 orësh. Nuk ka kufizime se sa vazhetime mund të ketë deri në konstituimin e organit ligjvënës.

Votimi i kryeparlamentarit dhe nënkryetarëve do t'i hapte rrugë formimit të Qeverisë së re të Kosovës. LV-së, si fituese të zgjedhjeve, i takon që e para ta propozojë mandatarin për ekzekutivin. Nëse brenda 15 ditësh nuk e formon ekzekutivin, atëherë presidentja Vjosa Osmani ka të drejtë ta mandatojë cilëndo parti që i garanton se i ka 61 votat për Qeverinë e re të Kosovës. Nëse edhe mandatar i dytë dështon ta formojë ekzekutivin, atëherë Osmani shpall mbajtjen e zgjedhjeve të reja.

Zgjerohet bashkëpunimi i FSK-së me ShBA-në

PRISHTINË, 6 MAJ - Komandantja e Qendrës për Studime Universitare, major Mimoza Budeci, ka përmbyllur vizitën zyrtare në ShBA, ku është pritur nga udhëheqësit më të lartë ushtarakë dhe civilë të Universitetit Norwich (Vermont) dhe Institutit të Teknologjisë Rochester (Nju-Jork). FSK-ja ka njoftuar se takimet janë zhvilluar në frymën e bashkëpunimit ndërinstitucional

dhe kishin për qëllim eksplorimin e mundësive për partneritet akademik dhe ushtarak ndërmjet Akademisë Ushtarake të FSK-së dhe institucioneve ushtarake dhe akademike amerikane. “Diskutimet u fokusuan në mundësinë e shkëmbimeve të kadetëve, stafit akademik, programeve të përbashkëta të trajnimit dhe zhvillimit profesional, si dhe nismave për avancimin e arsimit ushtarak

sipas standardeve ndërkombëtare. Të gjitha palët shprehën gatishmërinë për të ndërtuar ura bashkëpunimi që kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit të gjeneratës së re të liderëve ushtarakë. Këto takime përfaqësojnë një hap tejet të rëndësishëm drejt thellimit të marrëdhënieve të Qendrës për Studime Universitare me institucionet prestigjioze



ushtarakë dhe akademike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. KOMQSU ishte mysafire nderi në

ceremoninë e diplomimit të Universitetit të Norwichit”, ka njoftuar FSK-ja.

71 BANESA PËR 71 FAMILJE, BANIMI I PËRBALLUESHËM DHE SOCIAL PO JETËSOHET EDHE NË GJILAN

GJILAN, 6 MAJ - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendësministri në detyrë i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Jeton Raka, deputetë të Kuvendit, bashkë me kryetarin e komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, vendosën gurthemelin e kompleksit të Banimit të Përballueshëm dhe Social në këtë komunë. Ky kompleks do të përbëjë gjithsej 71 njësi banesore, me ç’rast 57 banesa do të jenë për banim të përballueshëm dhe 14 banesa do të jenë për banim social. Sipërfaqja e gjithëmbarshme ndërtimore e këtij kompleksi është afër 12 350 metra katrorë, kohëzgjatja e kontratës do të jetë tri vjet, dhe do të ketë katër tipa të banesave: 53 metra katrorë, 66 metra katrorë, 77 metra katrorë dhe 87

metra katrorë. “Qysh në fillim të mandatit tonë qeverisës patëm filluar përgatitjet për banimin e përballueshëm dhe social, duke e vendosur në agjendë qeveritare dhe më pastaj duke bërë studimin e fizibilitetit për komunat e ndryshme të cilat kanë aplikuar dhe këtu në Gjilan po e kurorëzojmë sot me këtë gurthemel fillimin e punimeve të cilët, po ritheksoj, do të zgjasin gjithsej tre vjet”, u shpreh kryeministri Kurti. Ai shtoi se përfitues do të jenë çiftet e reja, me ç’rast ato do të përfitojnë, nëse nuk e kanë të zgjidhur problemin e banimit dhe, gjithashtu, duhet që së paku njëri çift të jetë nën 37 vjeç. Këto banesa do të jenë edhe për familjet ku ka një prind vetushqyes. Kryeministri falënderoi kryetarin e komunës së Gjilanit,



përfaqësuesit politikë në këtë komunë, si dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që kanë punuar në vazhdimësi që të arrijnë këtë rezultat, meqenëse banimi është domosdoshmëri. Kësisoj, ky kompleks do të bëjë gjithsej 71 familje të lumtura në

71 banesa në komunën e Gjilanit, qoftë të banimit të përballueshëm apo social. Zëvendësministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Jeton Raka, tha se me miratimin e Agjendës Qeveritare për Banim të Përballueshëm dhe Social në

vitin 2021 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kanë synuar për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të sigurohet banim i denjë, i përballueshëm dhe i qëndrueshëm. Ndërkaq kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, e vlerësoi projektin për banim social dhe të përballueshëm në Gjilan, jetik për qytetarët. Ky projekt është bashkinvestim i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunave përfituese, ku komunat kontribuojnë me lokacionin dhe infrastrukturën e nevojshme. Deri tani janë nënshkruar katër kontrata me operatorët ekonomikë në shtatë lloje të komunës në Istogut, Gjilanit, Pejës dhe Podujevës, me vlerë totale prej 32 257 752.81 eurosh.

ATK-ja BËN THIRRJE TË PAGUHEN TATIMET PËR TË ARDHURAT E REALIZUARA NGA FURNIZIMET ELEKTRONIKE



PRISHTINË, 6 MAJ - Administrata Tatimore e Kosovës ua ka rikujtuar të gjithë personave fizikë joafaristë, personave fizikë afaristë dhe personave juridikë, se për të ardhurat e realizuara nga furnizimet elektronike, kanë detyrim t'i deklarojnë dhe t'i paguajnë tatimet në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Aktivitetet e ATK-së në vazhdimësi do të përqendrohen pikërisht te personat të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e realizuara nga furnizimet elektronike dhe nuk paguajnë tatimet për ato të ardhura.

Tatimpaguesit që nuk përmbyllin këto detyrime ligjore, duke mos deklaruar dhe/apo mos paguar tatimet për të ardhurat e realizuara nga furnizimet elektronike, do të përballen me masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor. “ATK-ja u bënë thirrje të gjithë personave të përfshirë në aktivitete lidhur me furnizimet elektronike, që të sigurohen se deklaratat e tyre janë të dorëzuara në kohë, janë të sakta dhe të plota, për të shmangur vonesat apo gjobat që mund të aplikohen, apo nëse vlerësohet se duhet të korrigjojnë deklaratat e

tyre, një gjë të tillë duhet ta bëjnë sa më parë, në mënyrë që të përmbyllin të gjitha detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor. Përmbyllja e këtyre detyrimeve tatimore kontribuon direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore”, ka njoftuar ATK-ja.

Krasniqi takon Ahmetin, flasin për pozicionin e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut

PRISHTINË, 6 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur në takim liderin e Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI), Ali Ahmeti. Ai ka bërë me dije se në këtë takim folën për sfidat dhe përpjekjet e vazhdueshme për t'i avancuar të drejtat dhe pozicionin e shqiptarëve në

Maqedoninë e Veriut. “Si gjithmonë, kënaqësi të pres edhe sot në takim liderin e BDI-së dhe një nga figurat më të rëndësishme politike të shqiptarëve në rajon, Ali Ahmetin. Diskutim vëllazëror e tejet i frytshëm. Folëm për sfidat dhe përpjekjet e vazhdueshme për të avancuar të drejtat dhe pozicionin e shqiptarëve në

Maqedoninë e Veriut. PDK-ja mbetet e përkushtuar për të forcuar lidhjet ndërshtetërore dhe për të mbështetur fuqizimin politik dhe institucional të shqiptarëve kudo që janë - jo vetëm në funksion të interesit kombëtar, por edhe si kontribuues të stabilitetit dhe integritetit euroatlantik në Ballkan”, ka thënë Krasniqi.



Policia e Prishtinës fillon kontrollin e kamionëve

PRISHTINË, 6 MAJ - Policia e Trafikut në Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, ka filluar zbatimin e një plani operativ për kontrollin e mjeteve të rënda - kamionëve në rajonin e Prishtinës. Sipas një

komunikate, ky plan ka për-
qëllim rritjen e sigurisë në
trafikun rrugor, parandalimin
e aksidenteve që përfshijnë
mjete të rënda dhe sigurimin e
respektimit të kriterëve ligjore
dhe teknike që rregullojnë këtë
kategori të automjeteve.

“Kontrollet po zhvillohen në pika të përcaktuara me rëndësi, ku po verifikohet gjendja teknike e mjeteve, pesha e ngarkesës, dokumentacioni i nevojshëm, si dhe respektimi i orarit të drejtimit nga ana e shoferëve.

Policia e Kosovës dhe Ministria e Infrastrukturës kërkojnë nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik që të jenë të kujdesshëm, të respektojnë rregullat dhe të kontribuojnë në sigurinë e përgjithshme rrugore”, thuhet në njoftim.



VDIQ KAQUSHA JASHARI, ISH-AKTIVISTE POLITIKE DHE THEMELUESE E PSDK-së



PRISHTINË, 6 MAJ - Ka ndërruar jetë në moshën 79-vjeçare Kaqusha Jashari, një nga figurat e njohura të skenës politike të Kosovës, themeluese dhe ish-kryetare e Partisë Socialdemokrate të Kosovës (PSDK), si dhe ish-deputete e Kuvendit të Kosovës.

E lindur në Prishtinë, Jashari vijoi shkollimin fillor dhe të mesëm në Kamenicë, Gjilan dhe Prishtinë, ndërsa Fakultetin e Ndërtimtarisë e nisi në Beograd dhe e përfundoi në Prishtinë. Deri në vitin 1975 punoi në

operativën ndërtimore në Ferizaj, pastaj u angazhua në funksione të rëndësishme politike në organet krahinore të Kosovës gjatë periudhës së autonomisë. Në vitet 1986-1988 ishte kryetare e Bashkimit të Sindikatave të Kosovës dhe kryetare e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës. Pas acarimit të raporteve politike në mes të Prishtinës dhe Beogradit, u largua nga pozita dhe deri më 1990 mbajti detyrën e drejtoreshës së autoritetit rrugor

të Kosovës.
Në periudhën e viteve '90 Jashari vazhdoi aktivitetin politik në radhët e PSDK-së, duke e udhëhequr këtë parti nga viti 1998 deri më 2008.
Ajo ishte pjesë e legjislaturës së dytë të Kuvendit të Kosovës (2006-2010) si deputete. Përveç politikës, Kaqusha Jashari njihej edhe për pasionin e saj për artin, veçanërisht pikturën, ku ka hapur disa ekspozita personale.
Të dhënat për këtë biografi janë marrë nga "Fjalori enciklopedik i Kosovës".

PROKURORIA SPECIALE E KOSOVËS NDALON NJË TË DYSHUAR PËR SPIUNAZH

PRISHTINE, 6 MAJ - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pas zhvillimit të hetimeve disamujore dhe aplikimit të masave të veçanta hetimore, ka arrestuar të martën personin H. S., shtetas i Republikës së Kosovës, i dyshuar për kryerjen e veprës

penale “Spiunazhi”, nga neni 124 i KPRK-së.

Aksioni dhe arrestimi është zhvilluar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Drejtorinë për Hetimin e Krimet të Organizuar dhe Krimet të Rënda si dhe asistencën e Agjencisë së Kosovës

për Inteligjencë.
Po në bazë të urdhërësës së
gjykatës kompetente, është kryer
bastisje në dy lokacione në Kosovë,
ku janë sekuestruar prova
materiale, përfshirë edhe disa
telefona, që dyshohet se janë
përdorur nga i dyshuari gjatë

kryerjes së veprës penale.
Prokurori i shtetit nga PSRK-ja ndaj
të dyshuarit ka nxjerrë aktvendim
për ndalim prej 48 orësh dhe ndaj
tij do të ndërmerren të gjitha
veprimet e nevojshme hetimore
për zhvillimin e suksesshëm të
procedurës penale.



SHSKUK-ja DHE UNIVERSITETI TURK GAZI DISKUTOJNË PËR BASHKËPUNIMIN NË SHËNDETËSI

PRISHTINË, 6 MAJ - Drejtuesit e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) kanë pritur të martën një delegacion nga Universiteti Gazi i Ankarasë së Turqisë, i kryesuar nga rektori, prof. dr. Ugur Unal, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij. Delegacioni u prit nga ushtruesi i detyrës së drejtorit të Departamentit Mjekësor në ShSKUK, Ardian Shefkriu, si dhe



ushtresues i detyrës së drejtorit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), Osman Hajdari.

Gjatë takimit palët diskutuan mundësitë e bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë, me theks të veçantë në trajnimin e stafit shëndetësor në fusha specifike dhe për trajnime të kuadrove deficitare.

U theksua gatishmëria e plotë nga ana e Gazi Universitetit për

ta mbështetur këtë bashkëpunim në mënyrë të strukturuar dhe afatgjatë. Drejtuesit e ShSKUK-së falënderuan delegacionin e Gazi Universitetit për vizitën dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke e konsideruar këtë takim hap të rëndësishëm drejt ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe zhvillimit profesional të stafit.

Gjenerallejtënant Jashari takon këshilltarët ushtarakë britanikë, flasin për zhvillimin e FSK-së



Prishtinë, 6 maj - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Bashkim Jashari, ka pritur të martën në takim lamtumirës/njoftues, këshilltarët ushtarakë britanikë, nënkolonel John Hunter dhe nënkolonel Mike Butler. Fillimisht gjeneral Jashari falënderoi nënkolonelin Hunter për shërbimin e deritanishëm si këshilltar

ushtarak, duke vlerësuar dhe shprehur mirënjohje të lartë për punën e tij. Gjithashtu, i shprehu mirëseardhje dhe i uroi për detyrën e re si këshilltar ushtarak NKOL Butler.

KOMFSK diskutoi për objektivat lidhur me zhvillimin e Forcës si dhe planet bilaterale lidhur me trajnimet, stërvitjet, pajisjet dhe aktivitetet të tjera të përbashkëta.

Ndërsa NKOL Hunter përgëzoi gjeneral Jasharin për zhvillimin e madh të FSK-së dhe për profesionalizmin e lartë të personelit të FSK-së. Në fund palët u pajtuan që marrëdhëniet bilaterale të zhvillohen edhe më tutje duke u fokusuar në fushat e zhvillimit të kapaciteteve ushtarake të FSK-së në funksion të përbushjes së misionit të saj.

SHALA: QEVERIA KURTI PO U GARANTON MILIONA KEDS-it, KESCO-s, NOA-s DHE GEN-it NË KURRIZ TË QYTETARËVE

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 MAJ - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Ferat Shala, ka ngritur shqetësimin lidhur me rritjen e çmimeve të energjisë elektrike për herë të tretë për qytetarët e Kosovës brenda një mandati të qeverisë Kurti. Shala në një konferencë për medie tha se kjo rritje është selektive dhe diskriminuese, sepse godet drejtpërdrejt konsumatorët shqiptarë, ndërkohë që retorika e dikurshme opozitare e kësaj qeverie premtonte ulje drastike të çmimeve dhe rikthim të kontrollit publik. “Kemi një realitet të dëmshëm, ku në vend të kontrollit publik, kemi fitime të garantuara për kompanitë private KEDS, KESCO, NOA dhe GEN, ndërsa qytetari i zakonshëm paguan gjithnjë e më shumë. Qeveria,

në vend se ta mbrojë interesin publik, është kthyer në lobuese dhe mbështetëse të aferave korruptive. Sot kemi brenda territorit të Republikës tregje energjetike mbi baza etnike. Sot kemi monopolizim mbi 90 % të importit të energjisë nga kompanitë GEN dhe NOA. Sot ne importojmë energji elektrike me çmim 100 % më shtrenjtë se në bursat ndërkombëtare. Sot bizneset që po pritët të dalin në tregun e lirë kanë marrë ofertat me 225 % më shtrenjtë se çmimi aktual i bursës. Sot shumë biznese po mbyllen apo po ikin jashtë Kosovës, shihni rastin e ‘Feronikel’-it. Sot kemi rënie të prodhimit në mënyrë drastike në KEK. E tërë politika e kësaj korporate është në favorizim të kompanive private importuese të energjisë”, theksoi ai. Shala tha se në këtë skemë të dështimit sistematik bëjnë pjesë



KOSTT-i dhe ZRRE-ja, e cila me zell të paprecedent ka garantuar rritje të vazhdueshme të çmimeve dhe është shndërruar në zëdhënëse dhe barrikadë mbrojtëse të qeverisë në shkuarje duke mbuluar në heshtje edhe aferat e mëdha korruptive, siç është rasti lidhur

me raportin e monitorimit nga ZRRE ndaj Ibër-lepencit. “Një sektor energjetik i degraduar. Stabilitet i cenuar. Transparencë dhe konkurrencë e munguar. Interesi publik i nëpërkëmbur. Dhe një klimë gjithnjë e më e rënduar për ekonominë dhe jetën e qytetarëve tanë. Të

vetmit që kanë përfituar janë kompanitë tregtare dhe grupet klienteliste, për të cilat kjo qeveri ka kujdes të veçantë përmes emërimeve të kontrolluara në institucionet kyçe. Sot, më shumë se kurrë, duhet të flasim për energjinë si të drejtë dhe si nevojë publike. Pa energji të qasshme dhe të qëndrueshme, nuk mund të ketë as mirëqenie, as zhvillim”, shtoi deputeti i PDK-së. Shala u ka bërë thirrje organeve të drejtësisë të hetojnë thellësisht çdo segment të sektorit energjetik. “Sapo të konstituohet Kuvendi i ri, do t’i shfrytëzojmë të gjithë mekanizmat parlamentarë për të shqyrtuar çdo veprim dhe mosveprim në menaxhimin e sektorit energjetik. Si PDK, do të jemi zë i fuqishëm në mbrojtje të interesit qytetar, në çdo instancë dhe në çdo forum”, ka thënë ai.

OEK-u KËRKON PEZULLIM TË VENDIMIT PËR SHTRENJTIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR BIZNESET

PRISHTINË, 6 MAJ - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka kërkuar nga institucionet e vendit ta shtyjnë të paktën për një vit hyrjen në fuqi të vendimit për dalje në tregun e lirë të energjisë elektrike për bizneset. Drejtuesi i Odës Ekonomike, Lulzim Rafuna, tha se bizneset kanë filluar t’i marrin ofertat e para dhe gjëja e parë që është vërejtur është çmimi shumë më i lartë sesa kanë paguar deri më tani. “Ofertat e para që kanë ardhur te të gjitha bizneset, te të gjithë sektorët janë mbi 200 për qind më të shtrenjta sesa çmimi i energjisë elektrike që kanë marrë deri më sot”, tha Rafuna. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka marrë vendim që nga data 1 qershor të gjitha



kompanitë e mëdha, konkretisht ato me mbi 50 të punësuar ose me qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro, të

kalojnë në tregun e hapur të energjisë. Sipas ZRRE-së, numri i tyre është mbi 1 000. Aktualisht këto biznese furnizohen nga Operatori për Furnizim me Energji (KESCO), si furnizuesi kryesor i licencuar për energji me çmime të rregulluara nga ZRRE-ja. Ndërsa nga 1 qershori kompanitë e mëdha duhet ta zgjedhin vetë furnizuesin e tyre, me çmime të parregulluara, të cilat përcaktohen nga kërkesa dhe oferta në treg. Rafuna tha se ky vendim duhet të shtyhet për të paktën një vit pasi, sipas tij, kjo do të shuante shumë biznese. “Kemi kërkuar që të shtyhet dalja në tregun e lirë dhe rritja prej 16.1-

përqindësh të suspendohet për arsye se ka mundësi dhe ka mekanizma që qeveria ta subvencionojë ose edhe ta gjejë mënyra të tjera se si ta ndihmojë biznesin se si ta kalojë sa më lehtë këtë periudhë kohore të mosdaljes në tregun e lirë”, deklaroi Rafuna. Aktualisht, në tregun e lirë të Kosovës janë të licencuara 18 kompani që ofrojnë furnizim me energji elektrike, shumica prej të cilave janë nga Kosova, por ka edhe kompani nga rajoni. Nga 1 maji kanë hyrë në fuqi tarifat e reja, me një rritje prej 16.1-përqindësh. Këto tarifa do të vlejnë edhe për bizneset që kanë nën 50 punëtor apo nën 10 milionë euro qarkullim.

MINT lanson thirrjen për 5 milionë euro grante për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme

PRISHTINË, 6 MAJ - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka lansuar thirrjen publike për përkrahjen financiare të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), në vlerë prej 5 milionë eurosh. Lansimin e kësaj thirrje e konfirmoi ministrija në detyrë, Rozeta Hajdari, në një konferencë për medie. “Qëllimi i kësaj skeme mbështetëse nga KIESA/MINT është që t’i mbështesim NMVM-të për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese në sektorët prioritarë industrialë dhe rritjen e konkurrueshmërisë

së tyre me produkte me vlerë për tregun ndërkombëtarë. Vizioni i Politikës Industriale të Kosovës është që deri në vitin 2030 industria e Kosovës do të transformohet në një industri më të integruar globalisht, që është në gjendje të prodhojë produkte me vlerë të shtuar të lartë dhe të ofrojë punësim të denjë”, ka thënë Hajdari. Ajo ka thënë se për ta lehtësuar shpalosjen e potencialit zhvillimor të sektorit të prodhimit në Kosovë, me mbështetjen qeveritare ndaj NMVM-ve prodhuese, synojnë arritjen e pesë objektivave të Politikës Industriale 2030: 1.



Zgjerimi i prodhimit industrial; 2. Zvogëlimi i deficitit tregtar industrial; 3. Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës; 4. Lehtësimi i industrisë së gjelbër dhe 5.

Maksimizimi i rritjes së vlerës së brendshme. Shuma e përgjithshme e kësaj skeme të granteve me 5 milionë euro për NMVM-të, për blerjen e makinerive të avancuara

prodhuese dhe përpunuese, është e ndarë në tri kategori. “Kategoria 1: me buxhet 2,000,000 euro për ndërmarrjet mikro, deri në 9 të punësuar, të cilat mund të përfitojnë një vlerë maksimale deri në 40,000 euro. Kategoria 2: me buxhet 2,500,000 euro për ndërmarrjet e vogla, me 10 deri në 49 të punësuar, të cilat mund të përfitojnë një vlerë maksimale deri në 80,000 euro. Kategoria 3: me buxhet 500,000 euro për ndërmarrjet e mesme, me 50 deri në 249 të punësuar, të cilat mund të përfitojnë një vlerë maksimale deri në 120,000 euro”, ka njoftuar ministrija Hajdari.

MISTERI I LUFTËS SË FTOHTË PËR ZHDUKJEN E ‘PALOMBARIT’

Nga: Myles Burke / BBC

Më 9 maj 1956, 68 vjet më parë, kryeministri britanik, Sir Anthony Edenm më në fund iu dorëzua presionit të mediave dhe turpit ndërkombëtar, dhe urdhëroi një hetim mbi zhdukjen misterioze të palombarit [zhytësit] të Marinës Mbretërore, kapitenit Lionel “Buster” Crabb.

Ky palombar i dekoruar u zhduk gjatë një vizite miqësore të udhëheqjes sovjetike, në Mbretërinë e Bashkuar, në kulmin e tensioneve të Luftës së Ftohtë. Kur u përhap lajmi se Crabbi ishte zhdukur, Admiraliteti, departamenti qeveritar përgjegjës për Marinën, publikoi një deklaratë të paqartë, duke thënë se palombari po testonte pajisjet nënujore në Gjirin Stoks në bregun e Hempshirit, ndërsa mendohej se ishte mbytur.

Por, historia u përmbys kur vizitorë rusët akuzuan mikpritësit e tyre për spiunazh. Sovjetikët pretenduan se kishin parë një zhytës pranë anijes “Ordzhonikidze” – anija që solli udhëheqësin sovjetik Nikita Hrushov [Khrushchev] në Mbretërinë e Bashkuar – ndërsa ajo ishte ankoruar në Portin e Portsmouthit. Pavarësisht se pyetjet u shtruan vazhdimisht në Parlament, Edeni refuzoi të jepte më shumë informacion, duke thënë: “Nuk do të ishte në interesin publik të zbuloheshin rrethanat në të cilat supozohet se kapiteni Crabb ka humbur jetën”. Refuzimi i qeverisë për të dhënë shpjegime vetëm sa shtoi dyshimet se Crabbi kishte qenë në një mision të fshehtë spiunazhi.

Katërmëdhjetë muaj pas zhdukjes së Crabbit, një trup pa kokë dhe pa duar, i veshur me kostum palombari, u gjet nga peshkatarët në portin e Çiçesterit në bregun jugor të Anglisë. Mungesa e gjurmëve të gishtave dhe dhëmbëve e bëri të vështirë identifikimin e trupit të gjymtuar, por një hetim i mëvonshëm përcaktoi se ishte trupi i Crabbit. E gjithë ngjarja turpëroi publikisht Edenin dhe dëmtoi përpjekjet e tij për të ndërtuar një marrëdhënie më miqësore me Bashkimin Sovjetik post-stalinist.

Kur u zhduk në vitin 1956, Crabbi veçse ishte i njohur për aventurat e tij të guximshme nën ujë. Me nofkën “Buster”, sipas notarit olimpik dhe aktorit amerikan Buster Crabbe – i famshëm në vitet ‘30 të shekullit XX – ai ishte ekspert në çmontimin e bombave nën ujë. Guximi i tij gjatë Luftës së Dytë Botërore i solli Medaljen [mbretërore] Xhorxh për heqjen e minave italiane nga anijet britanike në Maltë, si dhe



Dekoratën e Perandorisë Britanike (OBE) për pastrimin e minave në Livorno në Itali. Aventurat e tij amfibe, gjatë luftës, u dramatizuan më vonë në filmin e vitit 1958, Armiku i heshtur [The Silent Enemy], ku Crabbin e luante aktori Laurence Harvey. Edhe pasi u lirua zyrtarisht nga ushtria në vitin 1947, ai vazhdoi të zhytej për Ushtrinë – në funksione të ndryshme, përfshirë hetimet mbi nëndetëset e fundosura. Për dekada të tëra pas zhdukjes së palombarit, qeveria britanike ruajti me ngulm heshtjen mbi incidentin. Vetëm pas vitit 2006, falë kërkesave për informacion të lirë nga BBC-ja dhe pas deklasifikimit të dokumenteve sipas rregullit 50-vjeçar, nisën të dalin në dritë rrethanat e errëta të zhytjes fatkeqe të fundit të Crabbit.

Dosjet e deklasifikuara treguan se, që në fillim, shërbimet e sigurisë së Mbretërisë së Bashkuar ishin të etura për të shfrytëzuar vizitën e Hrushovit për të mbledhur informacion mbi kundërshtarët e tyre të Luftës së Ftohtë. Ata kishin propozuar vendosjen e mikrofonave të fshehtë në hotelin “Claridge’s”, ku udhëheqësia sovjetike do të qëndronte gjatë vizitës. Por, kryeministri e kundërshtoi kategorikisht idenë dhe e bëri të qartë se “aventura të natyrës së ngjashme ishin të ndaluara”. Megjithatë, MI6-shi rekrutoi Crabbin për të ndërmarrë një “veprim jozyrtar” me qëllim të hetimit të anijes ruse “Ordzhonikidze”. Natyra e saktë e misionit mbetet ende e

paqartë, por ish-agjenti i MI5-shit, Peter Wright, sugjeroi në librin e tij Zbuluesi i spiunëve [Spycatcher, 1987] se misioni kishte për qëllim të ekzaminonte dhe fotografonte dizajnin e avancuar të helikave të anijes.

Dy ditë para misionit, Crabbi dhe një tjetër agent i MI6-shit, me emrin Bernard Smith, u regjistruan në hotelin “Sally Port” në Portsmouth. Më 17 prill 1956, në mbrëmje, Crabbi u takua me një koleg ushtarak në një bar lokal. Ky koleg, emri i të cilit ishte hequr nga dosja, ishte një kapiten i Marinës Mbretërore, i cili pranoi ta ndihmonte Crabbin për të hyrë në portin e Portsmouthit për zhytjen e tij të fundit. Në vitin 2006, gazetari i BBC-së, Michael Buchanan, pati mundësinë të shqyrtonte deklaratën e dhënë nën betim, dikur të klasifikuar, të “njeriut të fundit që pa Crabbin të gjallë”.

“Ai thotë se kapiteni iu afrua disa ditë para zhytjes së fundit dhe e pyeti ‘nëse do të isha i gatshëm ta ndihmoja, krejtësisht në mënyrë jozyrtare dhe në kapacitet privat, në lidhje me një zhytje që do të bënte një ditë apo dy më vonë’. Ai theksoi më tej se në asnjë rrethanë nuk duhej të kontaktohej ndonjë autoritet përgjegjës detar”, ka thënë Buchanan.

Pak para orës shtatë, më 19 prill, kapiteni pa emër shkoi me Crabbin në Portin e Portsmouthit dhe e ndihmoi të vishte pajisjet dhe të kontrollonte pajisjet e zhytjes. Crabbi më pas notoi drejt anijes ruse, dhe nuk u pa më kurrë i gjallë. Marina

Mbretërore nuk bëri asnjë përpjekje për të kërkuar zhytësin e zhdukur, nga frika se do të alarmonte ekuipazhin e “Ordzhonikidze”-s. “Dokumentet zbulojnë më tej se nuk u bë asnjë përpjekje për kërkim dhe shpëtim për Crabbin, pasi ky nuk ishte një operacion i mirëfilltë”, ka thënë Buchanan. “Dhe, ata i detajuan përpjekjet e gjera [nga Admiraliteti] për t’u siguruar që të mos implikoheshin në një mision të dështuar për të cilin nuk kishin asnjë dijeni”.

Shërbimet e inteligjencës arritën në përfundimin se Crabbi ose ishte kapur nga sovjetikët, ose ishte eliminuar nga “reagimi” rus, ose kishte pësuar një “fatkeqësi natyrore”. Smith, agjenti i MI6-shit, hoqi sendet personale të Crabbit dhe u largua nga hoteli “Sally Port”. Disa ditë më vonë, policia hoqi faqet me të dhënat e tyre nga regjistri i hotelit “Sally Port”, gjë që vetëm e forcoi dyshimin për një mision të fshehtë. Nën presionin e MI6-shit dhe të qeverisë, Admiraliteti shpiku me ngut historinë e rreme se Crabbi ishte zhdukur gjatë një testi zhytjeje në Gjirin Stoks.


Të dhënat e takimeve tregojnë për panikun në nivelet më të larta të qeverisë. Zyrtarët kishin frikë se, nëse trupi do të gjendej, sovjetikët mund ta përdornin vdekjen e Crabbit për qëllime propagandistike. Howard Davis nga Arkivat Kombëtare i tha BBC-së, në vitin 2006, se dosja “e bën shumë të qartë se nuk ishte një operacion i Admiralitetit; ata nuk kishin asnjë lidhje me të dhe shohim se si përpigën të ndërtojnë një histori të cilën

mund ta tregojnë, në mënyrë të besueshme, për të përballuar pyetjet e pashmangshme nga shtypi”.

Por, pavarësisht publikimit të disa dokumenteve të klasifikuara të qeverisë, ajo që ndodhi saktësisht me palombarin, atë ditë të vitit 1956, mbetet ende e panjohur. Në vitin 1990, Joseph Zwerkin, një ish-agjent i inteligjencës detare sovjetike, pretendoi se një snajper sovjetik mbi kuvertën e “Ordzhonikidze”-s kishte parë zhytësin në ujë dhe e kishte qëlluar. Ndërsa, në vitin 2007, Eduard Koltsov, një ish-palombar 74-vjeçar rus, deklaroi se ia kishte prerë fytyrën Crabbit gjatë një përlëshjeje nën ujë, pasi e kishte kapur duke vendosur një minë në “Ordzhonikidze”.

Është sugjeruar gjithashtu se, pasi Crabbi ishte një bashkëpunëtor i Sir Anthony Bluntit – i cili u zbulua si spiun sovjetik në vitin 1979 – ai mund të ketë dezertuar. Nicholas Elliott, një ish-agjent i lartë i MI6-shit, që thuhet se ishte i përfshirë në zhytjen e fundit të Crabbit, besonte se zhytësi 47-vjeçar, i njohur për dashurinë e tij ndaj uiskit dhe cigareve, mund të kishte vdekur nga helmimi me oksigjen ose nga një sulm në zemër për shkak të lodhjes gjatë qëndrimit nën ujë.

Mund të kalojë edhe shumë kohë përpara se të dalin më tepër detaje mbi fatin e Crabbit. Ndërsa disa dokumente për këtë çështje janë bërë publike, të tjerat i janë nënshtruar zgjatjes së statusit të klasifikuar nga qeveria dhe nuk pritet të publikohen para vitit 2057. /Telegrafi/



KB Vëllaznimi vazhdon bashkëpunimin me Sharinin

Pa përfunduar ende sezoni 2024/25 në Superligën e Kosovës në basketboll, skuadra e Vëllaznimit ka filluar të mendojë për sezonin e ardhshëm. Klubi nga Gjakova ka bërë me dije se

në krye të ekipit për sezonin 2025/26 do të jetë trajneri Jeronimo Sharin, me të cilin ka vazhduar bashkëpunimin edhe për një vit tjetër. Te Vëllaznimi janë ndarë të kënaqur me punën

e trajnerit kroat, që tashmë ka firmosur kontratë njëvjeçare dhe ta konsolidojë ekipin për sezonin tjetër. Nën drejtimin e Sharinit, Vëllaznimi jo vetëm që ka pasur rezultate të mira, por

edhe ka shijuar suksese. Suksesi më i madh i ekipit gjakovar padyshim mbetet triumfi në Ligën Unike, duke fituar trofe për herë të parë pas gati tri dekadave. Sa i përket Superligës

së Kosovës, Vëllaznimi arriti deri në çerekfinale të “play-off”-it, seri kjo në të cilën u eliminua nga Sigal Prishtina me rezultatin e përgjithshëm 2:1 pas tri ndeshjeve të luajtura.

PSG-ja dhe Arsenali në kërkim të finales



“Epoka e re”

PARIS, 6 MAJ - 19 vjet pas zhgënjimit të parë në Ligën e Kampionëve në kryeqytetin francez, historia mund të përsëritet për Arsenalin sonte (e mërkurë), kur përballlet sërish me Paris Saint-Germainin në ndeshjen e dytë gjysmëfinale. Ousmane Dembele shënoi golin e vetëm në ndeshjen e parë në “Emirates”, duke i detyruar “topçinjtë” të tentojnë diçka që vetëm dy ekiye në histori e kanë arritur më parë, përmbysjen e një humbjeje në shtëpi në një gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Historikisht, PSG-ja është eliminuar vetëm një herë nga një raund me eliminim direkt pas fitores jashtë fushës në ndeshjen e parë, e kjo ka ndodhur kundër një ekipi anglez, Manchester United, në sezonin 2018-19. Në fundjavë, PSG-ja humbi 2-1 ndaj Strassbourgut me

FORMACIONET E MUNDSHME:

Paris Saint-Germain: Donnarumma; Hakimi, Marquinhos, Pacho, Mendes; Ruiz, Vitinha, Neves; Doue, Dembele, Kvaratskhelia.
Arsenal: Raya; Timber, Saliba, Kiwior, Lewis-Skelly; Odegaard, Partey, Rice; Saka, Merino, Martinelli.

një formacion të dytë, ndërsa Arsenali, me shumicën e titullarëve në fushë, pësoi një tjetër humbje zhgënjyese nga Bournemouthi, që përfitoi nga problemet e Arsenalit në mbrojtje. Për më tepër, vetëm Ajaxi më 1996 dhe Tottenhami më 2019 kanë arritur të kalojnë një gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve pas një humbjeje në shtëpi në ndeshjen e parë dhe tifozët e “Spurs”-it nuk do të jenë të prirë t’u japin këshilla rivalëve të tyre të përbetuar. Megjithatë, nuk është gjithçka negative për Arsenalin: udhëton në Paris me një seri prej shtatë ndeshjesh pa humbje si mysafir në të gjitha garat, me katër

fitore radhazi në Evropë, duke shënuar të paktën dy gola në secilën. Një përsëritje e fitores 2-1 ndaj Real Madridit në “Bernabeu” do t’ia jepte shansin për ta kërkuar kualifikimin në kohë shtesë. Por me PSG-në që ka shënuar 14 gola në tri ndeshjet e fundit si vendase në Ligën e Kampionëve, nuk është çudi që tifozët e Arsenalit të kenë frikë nga një tjetër zhgënjim evropian. Për PSG-në në dyshim janë dyshja Ousmane Dembele dhe mesfushori jugkorean Lee Kang-in. Arsenali do të jetë pa Jorginho, Gabriel Jesus, Kai Havertz, Gabriel Magalhaes dhe Takehiro Tomiyasu. Ndërsa Riccardo Calafiori është në dyshim.

SHKURT

Korenica në formacionin e javës në Rumani

Meriton Korenica edhe një herë ka zënë vend në ekipin më të mirë të javës në elitën e futbollit të Rumanisë. Mesfushori i Kosovës është përfshirë në ekipin më të mirë për xhiron e shtatë të garave shtesë “play-off”, “play-out”. Korenica ishte më i dalluari në fitoren e Clujit 1:0 ndaj Universtitateas, ndeshje kjo e luajtur fundjavën e shkuar. Në fakt, Korenica shënoi golin e vetëm në këtë përballje për ta ndihmuar Clujin të forcohet në pozitën e dytë në tabelë. Për Korenicën, i cili po vazhdon të shkëlqejë këtë sezon të Clujit, ky është goli i tij i nëntë në kampionat, kurse në total ka shënuar 12 gola dhe ka bërë 6 asistime në të gjitha garat. Ai iu bashkua Clujit në fillim të këtij sezoni dhe me skuadrën rumune ka kontratë deri në verën e vitit të ardhshëm.

Filluan punimet në qendrën rekreative-sportive te liqeni në Livoç të Epërm

Kanë filluar punimet për ndërtimin e qendrës rekreative-sportive te liqeni në Livoç të Epërm. Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me drejtorin e Shërbimeve Publike, Kushtrim Ibrahim, kanë parë nga afër punimet të cilat po zhvillohen te Liqeni i Livoçit të Epërm. “Një tjetër premtim po bëhet realitet. Filluan punimet në qendrën rekreative-sportive te liqeni në Livoç të Epërm”, ka thënë kryetari Alban Hyseni. I pari i Gjilanit theksoi se premtimi elektoral, ndërtimi i qendrës rekreative-sportive te Liqeni i Livoçit të Epërm po vazhdon. “Është një prej pak premtimeve që ka mbetur pa punuar dhe pa u kryer punimet deri në fund dhe faza e parë po përmbyllet”, ka shtuar Hyseni.

Sonte finalja e dytë në mes të Trepçës dhe Bashkimit

Mitrovicë, 6 maj - Superfinalet e “play-off”-it të ProCredit Superligës vazhdojnë me super sfida interesante. Beteja zhvendoset në Mitrovicë, ku të mërkurën nga ora 19:00 zhvillohet ndeshja e dytë finale. Takimin e parë e fituan prizrenasit 84:77, për

ta krijuar epërsinë prej 1:0 në serinë finale. Skuadra që shënon katër fitore shpallet kampione e Kosovës. “Xehetarët” synojnë fitoren për ta barazuar serinë në 1:1, ndërsa “portokallezinjtë” për ta krijuar epërsinë 2:0 dhe të afrohen te titulli.

Mitrovicasit synojnë mbrojtjen e titullit, kurse prizrenasit ta fitojnë titullin e parë pas vitit 2018, kur e fituan për herë të parë dhe të fundit. Ndeshja pritet të jetë mjaft interesante, ashtu si të gjitha takimet mes këtyre dy skuadrave në këtë edicion dhe një atmosferë e

jashtëzakonshme në Mitrovicë. Këto dy skuadra ishin përballur në finale të Kupës, ku fituan mitrovicasit. Ndërkohë, në garat e rregullta u përballën katër herë, me dy fitore ndaj njëra-tjetrës, ku të gjitha fitoret erdhën si vendas për Bashkimin dhe për Trepçën.



Shaqiri pas tetë vjetësh po ia sjell titullin Baselit

BASEL, 6 MAJ - Xherdan Shaqiri po përjeton një sezon të jashtëzakonshëm në Superligën e Zvicrës, duke e udhëhequr Baselin drejt titullit të parë pas plot tetë vjetësh pritje. Ylli nga Kosova ka qenë protagonist absolut, duke u shndërruar në liderin e padiskutueshëm të kampionatit. Me 15 gola dhe

plot 20 asistime në 30 ndeshje, Shaqiri është jo vetëm golashënuesi më i mirë i Superligës, por edhe asistuesi më i saktë. Rikthimi i tij verën e kaluar te Baseli ka rezultuar vendimtar. Edhe tifozët më besnikë nuk e kishin parashikuar një formë kaq të lartë. Në fushë, 33-vjeçari është bërë njeriu kyç, me një

ndikim që i ka munguar kampionatit prej vitesh. Baseli, falë paraqitjes së Shaqirit, është në krye të renditjes me 64 pikë pas 34 ndeshjesh, plot 9 më shumë se ndjekësi më i afërt. Dallimi i golave është mbresëlënës, +44, ndërsa ekipi ka realizuar 77 gola, shumë më tepër se ndjekësit më të afërt, si Lucerna me 61. Shaqiri ka

një karrierë të pasur pas vetes, me përvojë te klubet më të mëdha si Bayern Munich, Liverpool e Inter. Ai ka fituar dy herë Ligën e Kampionëve, dy herë Kupën e Botës për klube, tri herë Bundesligën dhe një herë Premierë Ligën. Edhe me përfaqësuesen e Zvicrës ka shkëlqyer, me 32 gola në 125 ndeshje. Në Zvicër



kishte fituar më parë tri tituj kampioni dhe dy Superkupa me Baselin, ndërsa tani është në rrugë të sigurt për t'ia rikthyer klubit lavdinë që i mungon që nga viti 2017.

Verstappeni: McLareni përpara nesh, mund të fitoj vetëm gara ku nuk mund të parakalohet

MILTON KEYNES, 6 MAJ - Max Verstappeni bëri gjithçka për t'u mbrojtur nga McLareni në garën e fundit të Formulës 1 zhvilluar në Majemi. Pasi mori "pole position" ditën e shtunë, holandezi i Red Bullit u përpoq ta ruajë kreun duke dueluar me Lando Norris në start, por ai që përfitoi ishte Oscar Piastri. Makinat McLaren rezultuan shumë të forta për një Red Bull që i mbinxeh gomat shumë më herët. Për pasojë, katër herë kampioni i botës u klasifikua në vendin e katërt, pa kapur dot as Mercedesin e George Russellit, që doli i treti. "Vendi i tretë ose i katërt nuk bën shumë ndryshim. Ne synonim të fitonim në Majemi, por nuk iu afruam dot objektivit tonë. McLareni është kilometra përpara nesh. Gomat tona mbinxehen shumë herët në krahësim me të tij. U përpoqa të mbrohesha, por nuk munda të



bëja më shumë", ka thënë Verstappeni. "Me makinën virtuale të sigurisë ishim pak të pafat, por në përgjithësi nuk kishim ritmin dhe ky është i vetmi aspekt që bën ndryshimin dhe në të cilin duhet të përqendrohemi", ka shtuar piloti holandez. Ai foli edhe për sa iu përket objektivave të tij sezonale.

"Mund të synoj fitore në pista ku do të jetë pak më e vështirë të parakalosh. Rivaliteti me Norrisin? Nga pikëpamja ime nuk ka asgjë të keqe, thjesht e mbrojta veten duke u përpjekur të bëja gjithçka që ishte e mundur për të qëndruar përpara pikërisht siç do të bënte kushdo", ka deklaruar holandezi.

New York përmbysi Bostonin

Nju-Jork, 6 maj - New York Knicks bën një hap të madh drejt finales së Konferencës Lindore, duke mposhtur kampionin aktual të NBA-s, Boston Celtics, në udhëtim pas kohës shtesë me rezultat të ngushtë 108:105. Me këtë fitore dramatike në TD Garden, Knicksi kalon në epërsi 1:0 në serinë gjysmëfinale të "play-off"-it. Celticsi e nisi ndeshjen në mënyrë të shkëlqyer dhe ndërtoi një epërsi të madhe prej 20 pikësh në mes të çerekut të tretë (72:52), por Knicksi nuk u dorëzua. Me një reagim të fuqishëm e përmbysi ndeshjen dhe hyri në çerekun e fundit me një epërsi prej nëntë pikësh (84:75), duke shënuar 32 pikë vetëm në çerekun e tretë. Në çerekun e fundit, të dyja skuadrat kishin mundësi për ta mbyllur ndeshjen brenda kohës së rregullt, por përballja e tensionuar shkoi në vazhdimë.



Aty Knicks tregoi më shumë qetësi dhe efikasitet, duke e fituar duelin me tri pikë diferencë. Drejt fitores për New Yorkun udhëhoqën OG Anunoby dhe Jalen Brunson, të cilët realizuan nga 29 pikë dhe katër kërcime secili. Josh Hart ishte i gjithanshëm me 14 pikë, 11 kërcime dhe tri asistime, ndërsa Karl-Anthony Towns

dha një tjetër paraqitje të fortë me 14 pikë dhe 13 kërcime. Nga ana tjetër, Celticsi u mbështet te dyshja Jaylen Brown dhe Jayson Tatum, që realizuan nga 23 pikë secili, por që nuk mjaftuan për fitore. Fitore në udhëtim ka marrë edhe Denver Nuggets që ka triumfuar në udhëtim tek Oklahoma City Thunder me rezultat 119:121.

SHKURT

Asllani në formacionin e javës në Serinë A

Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë, Kristjan Asllani, është përfshirë në ekipin më të mirë të javës në Serinë A të Italisë. Të martën "Calciomercato" ka njoftuar se Asllani është përfshirë në 11-shen e xhiros së 35-t të kampionatit italian pas paraqitjes së mirë në ndeshjen e fundit. Në fakt, Asllani ishte më i merituari që Interi ka mbetur në garë për titullin e kampionit të Italisë kur kanë mbetur edhe tri xhiro deri në fund të sezonit. Mesfushori shqiptar shënoi golin e vetëm në fitoren 1:0 të Interit ndaj Veronas, duke realizuar nga penalltia në pjesën e parë. Me këtë fitore Interi mbetet i dyti në tabelë me 74 pikë, tri më pak se Napoli që është lider.

Muslija në verë do të largohet nga Freiburgu

Florent Muslija mund të largohet nga SC Freiburg gjatë afatit kalimtar të verës. "Sky Sport Germany" raporton se një largim i mesfushorit është i mundshëm, pasi aventura e tij te klubi gjerman nuk ka dhënë rezultatet e pritura, as për lojtarin dhe as për klubin. Muslija iu bashkua Freiburgut në janar të vitit 2024, duke ardhur nga SC Paderborn, ku pati një formë të shkëlqyer në Bundesliga 2. Megjithatë, te skuadra e Bundesligës ai nuk arriti të përshtatej në mënyrë të qëndrueshme, pavarësisht prej mundësive të dhëna si nga trajneri i atëhershëm Christian Streich, ashtu edhe nga pasardhësi i tij, Julian Schuster. Që nga paraqitja e tij e fundit më 3 dhjetor në një ndeshje të Kupës së Gjermanisë, Muslija nuk është aktivizuar më. Në Bundesligë, 26-vjeçari ka bërë vetëm nëntë paraqitje, të gjitha si zëvendësues dhe nuk ka regjistruar asnjë gol apo asistim. Megjithëse ka kontratë të vlefshme deri në vitin 2028, lojtari me prejardhje nga Kosova shihet si një prej futbollistëve që mund të largohet në verë, dhe Freiburgu nuk pritet të bëjë pengesa për shitjen e tij.

Al Hilali, ofertë marramendëse për Fernandesin

Kapiteni i Manchester Unitedit, Bruno Fernandes, mund të jetë objektivi i një oferte të majme nga skuadra saudite Al Hilal këtë verë. Lajmi është konfirmuar nga e përditshmja "Daily Mail". Mediet konfirmojnë se përfaqësuesit e lojtarit portugez zhvilluan bisedime me Al Hilalin të hënën. Gjithashtu, ka pasur një kontakt fillestar midis dy klubeve vitin e kaluar përpara se Fernandesi ta nënshkruante kontratën e tij të re në "Old Trafford". Kontrata e tij me "dajtë e kuq" skadon në verën e vitit 2027, e cila ka një mundësi zgjatjeje 12-mujore. Gjithsesi, vështirë se Manchester Unitedi do të heqë dorë nga kapiteni, që ka qenë shpesh vendimtar këtë sezon. Në mars, Fernandesi u lidh me një transferim te Real Madridi, që e shtyu trajnerin Ruben Amorim, të deklaronte se bashkëkombësi i tij nuk do të largohet nga klubi. Sulmuesi këtë sezon ka shënuar 19 gola dhe ka dhënë 18 asistime në të gjitha garat.

Arsenali planifikon organizimin e një garde nderi për Liverpoolin në 'Anfield'

Përkundër humbjes së garës së titullit në Ligën Premierë, Arsenali pritet ta nderojë kampionin e ri të Ligës Premierë në ndeshjen mes tyre këtë javë. Sipas "Daily Mail",

Arsenali është i vendosur ta ruajë traditën e futbollit duke i dhënë Liverpoolit një "gardë nderi" përpara përballjes së tyre të ardhshme në "Anfield" këtë të diel. Pavarësisht debatit

të kohëve të fundit mbi rëndësinë e gjestit - veçanërisht pas disa reagimeve negative pas versionit të Chelseat - skuadra e Mikel Artetas do të vazhdojë me nderimet si

shenjë respekti për kampionët e rinj të Ligës Premier. Klubi londinez thuhet se e sheh gjestin jo si një detyrim, por si një simbol të sportivitetit dhe profesionalizmit. Kjo do të vijë

pavarësisht se Arsenali humbi titullin e Ligës Premierë për herë të tretë radhazi, dy herët e fundit ndaj Manchester Cityt dhe tani ndaj skuadrës së Arne Slot.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gieipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



Prishtinë, 05.05. 2025

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „SVB ENERGY“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 812074532 me adresë: Rr. „20 Qershori“ pn, Komuna e Istogut Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.01.2025 ka dorëzuar në Zyren e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelët solare me kapacitet të instaluar prej **3 MW** ZK Sinajë, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës.

Shoqëria „SVB ENERGY“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Sinajë, Komuna e Istogut, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT sic janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.2763-2/24 dt. 30.05.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Pëlqimin nr. 11-351-241-23 dt. 22.11.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i Lëndës: Nr. 11-351-25250/111 të datës 15.10.2024 për “Ndërtimin e Parkut të Energjisë Solare Fotovoltaike me kapacitet prej 3 MW, ZK Sinajë, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Pëlqimin Elektroenergetik Nr. 19361 dt. 20.12.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Deklarimet financiare;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC)
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund të paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: skender_rugova@hotmail.com, arber.lubishtani@elen-ks.com dhe LEGAL-LEKONJING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për atë që e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albulena Hajdari shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Fitim Dafota shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Albulena Hajdari shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u "Vëllaznimi" Cërmjan Gjakovë nga kl. 1-5.
- Helena Nushi B.I. shpall të pavlefshme nr. Unik: 811911503 të lëshuar nga ATK.
- Sheremet Sadiku, shpall te pavlefshme vërtetimin e lëshuar nga Qendra e Aftësimit Profesional – Mitrovicë, profili Zdrukthëtari, vërtetimi mban numrin: 174/2005.
- Agjensioni Doganor "Doni - Shped", shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numer Unik Identifikues: 810354639.
- Gezim Kosova shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Motrat Qiriaz" Prizren.
- Ensar Butuc shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Motrat Qiriaz" Prizren.
- Laokont Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Syla Hodaj B.I. shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr.811142562 të lëshuar nga ATK.
- Leotrim Qevani shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë.
- Ari Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Lirigzon Morina nga Senoci i Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e shkollës së mesme profesionale "Selajdin Mullaabaz-Mici", Rahovec.
- Fadil Dujaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.
- Besart Bardhi nga Tropoja e Shqipërisë shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 12 dhe diplomën e lëshuar nga Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh . A .Pejë me datë 07.05.2025, shpall konkurs të brendshëm për këto vende të punës :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita : Kontabilist - 1 pozitë

Vendi punës : Klinë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 3.5

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Organizon dhe mban kontabilitetin e Ndërmarrjes;
- Siguron së të gjitha transaksionet janë trajtuar në përputhshmëri me standardet e kontabilitetit, rregulloret e brendshme, si dhe legjislacionit që rregullon trajtimin e regjistrimeve në kontabilitet;
- Bën regjistrim e faturave të blerjes dhe shitjes sipas rregullores;
- Bën llogaritjen e pagave për punëtorët e ndërmarrjes dhe mbanë shenim për çdo pagë, të cilat i arkivon në baza mujore;
- Bënë barazimin mujor të arkave, inkasantëve dhe faturistëve;
- Organizon, mbikëqyr dhe jep rekomandime shefit të faturimit dhe inkasimit në lidhje me punën dhe azhurnitetin e tyre;
- Organizon, mbikëqyr dhe jep rekomandime arkave, ne lidhje me punën dhe azhurnitetin e tyre, siguron që të gjitha hyrjet daljet janë në rregull dhe më kohë të azhurnuar, si dhe saldon e arkës pas deponimit ditor të pazarit në bankë.
- Organizon, mbikëqyr dhe jep rekomandime inspektorëve të brendshëm në lidhje me punën dhe azhurnitetin e tyre me inspektimin e terrenit gjatë regjistrimit të konsumatorëve të rinj; aktivizimin, pasivizimin, si dhe shqyrtimin e kërkesave-vërejtjeve të konsumatorëve.
- Organizon, mbikëqyr dhe jep rekomandime zyrtarit për ankesa dhe kërkesa në lidhje me punën dhe azhurnitetin e tij;
- Raporton punën javore, mujore dhe vjetore tek zyrtari kryesor financiar;
- Kryen punë të tjera me urdhëresë të ZKF-së;
- Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mbanë përgjegjësi disiplinore;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzkativ.

- a. Kushtet e përgjithshme :
- CV ;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
 - Letër motivimi ;
 - Kopja e letërnjoftimit ;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;
- b. Kushtet e veçanta : (kualifikimet profesionale)
- Diplomë Universitare, Fakultetin Ekonomik;
 - Ai/Ajo duhet të ketë përvojë të menaxhimit apo profesioneve relevante, aftësi organizative dhe analitike, dhe aftësi ndër njerëzore;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
 - Njohuri për punë në kompjuter (MS Word, Excel etj.);
 - Përvojë pune së paku tre (3) vite të dëshmuar.

Pozita : Mbledhës i borxheve (Inkasant) - 1 pozitë

Vendi punës : Klinë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 1.8

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Obligohet që në terren të sillt korrekt dhe të ketë të veshur uniformë dhe shenjë identifikimi të ndërmarrjes NPL Ambienti Sh.A;
- Dërgon faturat e printuara mujore që është i ngarkuar tek secili klient. Çdo parregullësi në faturë duhet ta kthejë në rillogaritje (korrigjim) tek shefi i faturimit dhe inkasimit dhe arkëton pagesat më bilok të vërtetuar nga ndërmarrja;
- Përcjell gjendjen në terren dhe regjistron klientë të rinj, ndërrimin e pronarëve, pasivizimet, korrigjimet e adresave dhe merr shënimet tjera të cilat i përkasin punëve dhe detyrave të inkasantit në lidhje me terrenin e tij dhe të njëjtat i dorëzon tek shefi i inkasimit dhe faturimit;
- Dorëzon arkëtimet e pagesave me shënimet e duhura tek faturistët;
- Në bazë të raportit të lëshuar nga faturistët (Arkëtimi sipas Dokumenteve Analitke), kontrollojnë raportin së a janë në përputhje me pagesat në bllokun e dorëzuar dhe pasi që janë të gjitha në rregull bën dorëzimin e mjeteve në arkë;
- Pas dorëzimit të mjeteve në arkë, nënshkruan mandat arkëtim të dokumentit dhe atë urdhër e ruan për barazim mujor tek shefi i inkasimit dhe faturimit;
- Jep përgjegjësi për çdo dëftesë të lëshuar nga blloku i tij me numër serik;
- Jep përgjegjësi për çdo faturë të dyfishuar dhe çdo formë tjetër, ku dëmtohet buxheti i ndërmarrjes;
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë të tjera me urdhëresë të shefit të inkasimit dhe faturimit;
- Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja, ku për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzkativ.

- a. Kushtet e përgjithshme :
- CV ;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
 - Letër motivimi ;
 - Kopja e letërnjoftimit ;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.
- b. Kushtet e veçanta : (kualifikimet profesionale)
- Shkolla e mesme (preferohet shkolla e mesme ekonomike);
 - Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit : Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 07.05.2025 deri me 22.05.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh . A .Pejë me datë 07.05.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Ngasës i kamionit - 1 pozitë

Vendi punës : Klinë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 2.4

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Drejton automjetin, kujdeset për rregullsinë e tij dhe është përgjegjës për ngasjen e sigurtë, duke i respektuar rregullat trafikut rrugor dhe të sigurisë;
- Kujdeset për higijenën dhe pastërtinë e automjetit, si dhe para çdo ndezje të automjetit kontrollon gjithëmbarshtëm çdo pajisje dhe cep të automjetit dhe në momentin që vëren problem mekanik apo elektrik lajmëron kryepunëtorin, dhe nëse prishja ka ditë që nuk është rregulluar, lajmëron dhe MO, KE për problemin elektrik apo mekanik;
- Çdo ditë merr urdhëresën e punës nga kryepunëtori dhe koordinatori operativ në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve;
- Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatin për fikjen zjarrit dhe paisjet përcjellëse të domosdoshme në komunikacion;
- Çdo ndalje për mbledhjen e mbeturinës është i obliguar që ta bëjë sigurt dhe mundësisht në skajin e rrugës ose jashtë rrugës. Gjatë lëvizjes prapa dhe gjatë marrjes së mbeturinave me shpejtësi të vogël është i detyruar të lëshojë 4 treguesit e drejtimit dhe çdo herë për çdo veprim në trafik rrugor të jetë i sigurtë se ai veprim do të bëhet pa shkaktuar incident;
- Duhet të pajisjet me certifikatë të rregullit shëndetësore për ngasje të automjetit dhe e njëjta të jetë valide;
- Nuk duhet të konsumojë duhan, alkool, apo narkotikë përgjatë drejtimit të automjetit, si dhe barëra të cilat kanë shenjë të trekëndëshit të sigurisë me ngjyrë të kuqe në vend të dukshëm;
- Në rast të prishjes së automjetit me të cilin punon është i obliguar që të drejton automjet tjetër dhe kryen edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit, Kordinatorit Operativ;
- Është i obliguar të menaxhoi dhe të mbaj nën kontroll ekipin e punëtorëve fizik;
- Është i obliguar të mbajë uniformën e ndërmarrjes dhe PPM (pajisjet personale mbrojtëse);
- Kryen pune bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit,
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzkativ

- a. Kushtet e përgjithshme :
- CV;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
 - Letër motivimi;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.
- b. Kushtet e veçanta : (kualifikimet profesionale)
- Përgatitje profesionale - Shkollim të mesëm, kategori përkatëse (C1-C);
 - Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Pozita : Punëtor fizik në mbledhjen e mbeturinave - 4 pozitë

Vendi punës : Klinë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 2.2

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave;
- Mbledh mbeturinat dhe bën zbrazjen e kontejnerëve dhe mjeteve të tjera për hedhurina apo qeseve nga shfrytëzuesit e shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror;
- Pas zbrazjes së kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdes;
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve;
- Është i obliguar të mbaj uniformën e ndërmarrjes dhe pajisjet e tjera të punës dhe mbrojtjes në punë (PPM);
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëresë të shoferit dhe kryepunëtorit;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drjtpërdrejt, Kryeshefit Ekzkativ

- a. Kushtet e përgjithshme :
- CV;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
 - Letër motivimi;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.
- b. Kushtet e veçanta : (kualifikimet profesionale)
- Të ketë njohuri për shkrim dhe lexim përparësi shkollimi fillor;
 - Aftësi fizike dhe psikike të dëshmuar;
 - Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë

Mënyra e Aplikimit : Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 07.05.2025 deri me 22.05.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

